



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-0/DPK  
Dep. 03  
Nr. i faq.  
Broj stranica  
Nr. pages

Nr. Prot. 01-880/16  
Br. Prot.  
Pro. No.  
Data  
Datum  
Dati

29-02-2016



|                        |                                                                                                                     |
|------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATE/A:                | 26.02.2016                                                                                                          |
| REFERENC-Ë:            | AKK-DPKPP 03-03/527/16                                                                                              |
| PËR/ZA/TO:             | z. Salih KQIKU<br>Drejtore i Departamentit të Prokurimit në Komunën e Gjilanit                                      |
| CC:                    | z. Lutfi HAZIRI<br>Kryetar i Komunës së Gjilanit                                                                    |
| NGA/OD/FROM:           | Hasan PRETENI<br>Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit                                                           |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me Tenderin " Furnizim me material fidanor – mjedër për nevoja të fermerëve të Komunës së Gjilanit " |

*I nderuari z. Kqiku ,*

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin " Furnizim me material fidanor – mjedër për nevoja të fermerëve të Komunës së Gjilanit " me numër prokurimi Gi651-16-005-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## O P I N I O N

Në lidhje me monitorimin e procesit rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve lidhur me aktivitetin e prokurimit publik me titull " *Furnizim me material fidanor – mjedër për nevoja të fermerëve të Komunës së Gjilanit* " me numër prokurimi Gi651-16-005-121, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit.

### *Arsy etimi*

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 08.02.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli *AKK-03-3-523/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "***Furnizim me material fidanor – mjedër për nevoja të fermerëve të Komunës së Gjilanit***" me numër prokurimi Gi651-16-005-121, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit.

Me datë 19.02.2016, Agjencia kundër Korrupsionit ka paraqitur njoftimin për pjesëmarrje në vëzhgim, pranë Autoritetit Kontraktues të cilin e ka njoftuar se Agjencia do të merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në procesin rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve. Agjencia pasi ka trajtuar dokumentet në dispozicion dhe ka marr pjesë në monitorimin rreth vlerësimit të tenderëve ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë për furnizim me vlerë të mesme të kontratës.

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 6 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 3 prej tyre.

Komisioni për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve, pas vlerësimit të ofertave ka konstatuar se nga tri ofertat e pranuar për këtë tender, asnjëra prej tyre nuk janë oferta të përgjegjshme, pasi që nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, andaj në mungesë të ofertave të përgjegjshme ka rekomanduar anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Me datë 24.02.2016 Autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit ka bërë anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin se nuk ka oferta të përgjegjshme, njoftim ky i cili është publikuar në faqen zyrtare të Komisionit rregullativ për prokurimin publik.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe kërkesën e njësisë kërkuese ka vërejtur se Autoriteti kontraktues **ka kërkuar që Fidanët të jenë të variatetit "Polka"**, kërkesë kjo e cila konsiderojmë se bien ndesh me nenin 28 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues nuk duhet të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

Bazuar në legjislacionet në fuqi për prokurim publik me përcaktimin e llojit të prodhimit të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund ti referohet një standardi vendor, europian ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkohet emërtimi i të këtyre furnizimeve.

Njësia kërkuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të

specifikimeve teknike të mos formuloj specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë t'i diskriminoj Operatorët tjerë ekonomik, si dhe të mos caktoj kërkesa të cilat do ti pengonin operatorët ekonomik për të dorëzuar tenderët e tyre.

Tek kërkesa e njësisë kërkuese që në rastin konkret është Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari tek kërkesa 2 dhe në pjesën *III.1.3. Kushtet tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës* të dosjes së tenderit, Autoriteti kontraktues ka kërkuar që fidanët duhet të kenë origjinë nga vendet e Bashkimit European, kërkesë kjo e cila nuk është në pajtim me nenin 7 të LPP-së. Sipas këtij neni “ Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik “.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 dhe nenin 18 të udhëzuesit operativ të prokurimit publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

**Me respekt !**